

10 Këshilla rreth veprimit me para

- Ndërtoni një **pasqyrë** mbi të ardhurat dhe shpenzimet e juaja përmes një **buxheti**.
- Sa herë të jetë e mundur ndani në një **llogari kursimore një pjesë të rrogës së 13-të për gjëra të paparashikuara** si p.sh. për shpenzime të dentistit ose për zëvendësim të televizorit të prishur.
- Zvogëloni kohën e paraparë për transfertat e pagesave të rregullta duke i zëvendësuar me urdhra afatgjate transferi dhe sistem të debitimit direkt, p.sh. për qira, sigurim shëndetësor, përkujdesje fëmijësh, faturën e celularit etj.
- **Paguani poashtu tatimet dhe sigurimet mundësisht çdo muaj me** urdhra afatgjate dhe sistem të debitimit direkt.
 - Paguani tatimet e juaja çdo muaj direkt në zyrat tatimore.

Tatimet janë shpenzim i lartë. Informohuni përmes internetit ose në zyrën tatimore se sa do të jenë tatimet në vitin vijues, Administrata Tatimore e Konfederatës Zvicrane, Kalkulatori i Tatimeve :
<http://www.estv2.admin.ch/d/dienstleistungen/steuerrechner/steuerrechner.htm>
 - Plotësoni deklaratën e juaj tatimore ose angazhoni dikë për ta plotësuar. Në rast të mosdorëzimit të deklaratës tatimore do të ndëshkoheni apo do të ngarkoheni me tatime më të larta.
- Transferoni për **çdo muaj** në një **llogari kursimore shumë e ndara** për pushim vjetor, për blerje të mëdha dhe për faturat e pritshme vjetore.
 - ▶ Pas gjithë kësaj në xhirollogari do t'ju mbetet shuma mujore për jetesë (ushqim, kohë të lirë, gardërobë...).
- **Shpenzimet e banimit** përshtirë shpenzimet shtesë nuk duhet të kalojnë 25% të të ardhurave.
- **Kartelat e konsumatorëve dhe kartelat kredi** janë praktike por i shtyjnë shumë njerëz për të shpenzuar më shumë para. Në rast të më shumë kartelave humbet shpejt pasqyra e përgjithshme. Përdorni vetëm një ose asnjë kartelë kredie.

- Nuk është gjithnjë e thjeshtë të keni masën e duhur të sigurimeve. Kontrolloni **sigurimet** e juaja nëse janë mbi apo nën nivelin e duhur.
- Provoni me kujdes shumë të madh nëse do të shfrytëzoni **kredi private** apo **kontratë lizing**.

Në çdo rast duhet së paku të siguroheni:

- A është buxheti im realist?
- Me çfarë ndryshime buxhetore duhet të llogaris gjatë kohëzgjatjes së kontratës?
- A më mjafton buxheti kthimin e kësteve mujore gjatë kohëzgjatjes së kontratës?
- Si mund t'i përmbush obligimet e mia në rast të ndonjë përkeqësimi financiar (papunësi, ndarje/ shkurorëzim etj.)? A më ofron ndonjë mbrojtje sigurimi i kësteve kreditore?
- Cilat kërcënime mund të më shfaqen në rast të mospërmbushjes së obligimeve kontraktuale? Çka do të thoshte kjo mospërmbushje për mua.
- Keni kujdes me **personat privat ndërmjetësues**. Disa nga këta persona janë kryesisht të interesuar në lidhjen e kontratave, meqë nga kjo marrin provizione.

Shumë nga këto pyetje nuk janë të lehta për t'u përgjigjur. Ne ju këshillojmë që para çdo lidhje kontratash të shfrytëzoni ndihmën profesionale nga ndonjë institucion për këshillime buxhetore ose të borxheve.

Në rast se për çfarëdo arsye nuk jeni në gjendje t'i përmbushni obligimet e juaja financiare, ju rekomandojmë të kërkonin ndonjë institucion për këshillime buxhetore ose të borxheve.

www.budgetberatung.ch

Informata

Shembuj buxheti për situata të ndryshme jetësore (familje, persona që mbajnë vetëm familjen, persona madhor në shkollim....

www.caritas-schuldenberatung.ch

Preventivë dhe edukim financiar
Këshilla kursimi
Kredi/ lizing
Kërkesat/ Pengjet
Sanimi i borxheve, bankrotim privat
Shkresa mostër

Adresa

Institucione këshillimi për buxhet

Institucione këshillimi për borxhe

Adresa tjera

Shërbimi social i bashkësisë, Institucione për këshillime të rinjve dhe familjes, Caritas-i